



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE

Nr. 6606/1 Prot.

Korçë, më datë 23.06.2026

Lënda: Shkresë përcjellëse

**DREJTORIA E MARRËDHENIEVE ME PUBLIKIMET
SEKTORIT TË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Korçë nr. 15 datë 29.01.2026 “Për miratimin e projektit “*Stimulimi i Industrive Kreative*” dhe përzgjedhjen e partnerit për zbatimin e këtij projekti në qytetin e Korçës” i ndryshuar, Marrëveshjes nr. 1292 prot. datë 09.02.2026 midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë “Për financimin e projektit “*Stimulimi i Industrive Kreative*”, dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 730, datë 22.06.2026 “Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave të konkurrentëve për marrjen me qira të 3 (tre) ambienteve për zhvillimin e aktiviteteve të artizanëve dhe prodhuesve kreative lokalë për realizimin e projektit “*Stimulimi i industrive kreative*” më anë të kësaj shkrese kërkojmë nga ana juaj të procedoni me afishimin e kësaj shpallje për bërjen me dije të gjithë subjekteve që janë të interesuara për ofrimin e ofertave për 3 (tre) ambientet që do të merren me qira dhe që do të përdoren për zhvillimin e aktiviteteve të artizanëve dhe prodhuesve kreativë lokalë për realizimin e projektit “*Stimulimi i Industrive Kreative*”.

Bashkangjitur njoftimi për afishim.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE

ANXHELA DISHNICA QERAMIXHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKIMET
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Nr. 6606 Prot.

Korçë, më datë 23/062026

NJOFTIM

**“SHPLLJE PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE TË KONKURRENTËVE PËR
MARRJEN ME QERA TË 3 (TRE) AMBIENTEVE PËR ZHVILLIMIN E
AKTIVITETEVE TË ARTIZANËVE DHE PRODHUESVE KREATIVE LOKALË PËR
REALIZIMIN E PROJEKTIT “STIMULIM I INDUSTRIVE KREATIVE”**

Në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Korçë nr. 15, datë 29.01.2026 “Për miratimin e projektit “*Stimulimi i Industrive Kreative*” dhe përzgjedhjen e partnerit për zbatimin e këtij projekti në qytetin e Korcës” i ndryshuar, Marrëveshjes nr. 1292 prot. datë 09.02.2026 midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë “Për financimin e projektit “*Stimulimi i Industrive Kreative*”, dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 730, datë 22.06.2026 “Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave të konkurrentëve për marrjen me qera të 3 (tre) ambienteve për zhvillimin e aktiviteteve të artizanëve dhe prodhuesve kreative lokalë për realizimin e projektit “*Stimulimi i industrive kreative*” Bashkia Korçë njofton se të gjithë subjektet që janë të interesuara për ofrimin e ofertave duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

2.1 Përshkrimi i Ambienteve që do Marrin me Qira

- Numri i ambienteve: 3 (tre);
- Sipërfaqja e ambienteve: Jo më pak se 10 m2 për secilin ambient;
- Vendndodhja: Tek Pazari i Korcës;
- Përshkrimi: Hapësira të pamobiluara të dizajnuara për të përfshirë një mjedis zyre dhe një sallon pritjeje. Te pajisura me tualet.
- Vlera mujore e qirasë do të jetë jo më shumë se 300 lekë për m2.

2.2 Qëllimi i Përdorimit

Ambientet që do të merren me qira do të përdoren për zhvillimin e aktivitetit të artizanëve dhe prodhuesve kreative lokalë për realizimin e projektit “*Stimulimi i Industrive Kreative*”.

2.3 Kriteret për Subjektet Ofertuese

Subjektet/personat fizikë ofertues duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Fotokopje të kartës së identitetit dhe/ose fotokopje të çertifikatës së regjistrimit si subjekt (Nipt-i);
- Oferta me vlerën e qirasë mujore të firmosur nga subjekti/personi fizik;
- Të paraqesin dokumentacionin e pronësisë për ambientet e ofruara. (Çertifikatë pronësie; kopje karte dhe fragment harte treguese, të 3 (tre) muajve të fundit).
- Të ofrojnë një planimetri të ambientit të ofruar dhe/ose foto bashkangjitur;

2.4 Afatet dhe Kushtet e Qirasë

- Afati i Qirasë: Qiraja do të jetë për një periudhë prej 3 (tre) vjeçare.
- Shuma e Qirasë: Shuma e qirasë do të përcaktohet në bazë të ofertave të paraqitura dhe në përputhje me vlerën e tregut.
- Kushtet e Përdorimit: Ambientet duhet të përdoren ekskluzivisht për qëllimet e përcaktuara në projekt dhe të mirëmbahen sipas standardeve të përcaktuara nga Bashkia Korçë.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë brenda **afatit 2 javor nga data e afishimit** dokumentacionin e kërkuar pranë **zyrës së Protokoll Arkivës në Bashkinë Korçë në zarf të mbyllur**. Vlerësimi i dokumentacionit do të bëhet në sallën e Mbledhjes, Kati i I, në dt 08.07.2026 në Bashkinë Korçë.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në numrin e telefonit [+35582243353]; në adresën e postës elektronike: info@bashkiakorçe.gov.al ose të vizitoni faqen zyrtare të Bashkisë Korçë.

Kjo shpallje do të afishohet në stendën e Bashkisë Korçë dhe do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Korçë.

U shpall sot në Stendat e Bashkisë Korçë dt. 23 / 06 / 2026.

Spektori i Mardhënieve me Publikun


KRYETARI
Sotirag Filo
